



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 450 Prot

Vlorë, më 28 . 03 .2018

VENDIM

Nr. 10 , Datë 21 / 03 /2018

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21.03.2018 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Sarandë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 1, datë 16.01.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkues **Z. Vangjel Qyrku (subjekti Z. Vangjel Qyrku me gjeneralitetet sipas certifikatës së vitit 1974 – 1985)** për një objekt banimi (2 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 46.3 m² kati përdhe, 40.0 m² kati i parë dhe sipërfaqe trualli 412 m² që ndodhet në ZK 8641, lagjja Nr. 2, Sarandë me nr. Pasurie 19/365 dhe nr. Pasurie 19/367 dhe kufizohet nga veriu me pasuritë 19/346, 19/347, 19/31, nga jugu me pasuritë 19/57, 19/69, 19/158, nga lindja me rrugë dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 19/364.
2. Të miratojë Vendimin Nr. 1/2, datë 24.10.2017 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkues **Z. Thodhori Balça (subjekti Z. Thodhori Balça me gjeneralitetet sipas certifikatës deri më 10.08.1991)** për një objekt banimi (3 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 120.5 m² të tre katet dhe sipërfaqe trualli 200 m² që ndodhet në ZK 8641, lagjja Nr. 1, Sarandë me nr. Pasurie 12/399 dhe kufizohet nga veriu me rrugë, nga jugu me pasurinë 12/427, nga lindja me pasurinë 12/86 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 12/90.
3. Të miratojë Vendimin Nr. 1/1, datë 16.01.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkues **Z. Kastriot dhe Shpëtim Demçe (subjekti Z. Kastriot dhe Shpëtim Demçe bazuar në testamentin nr. 7, datë 14.12.1994 me gjeneralitetet sipas certifikatës me përbërje familjare të vitit 1974-1985)** për një objekt banimi (1 Kat)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

me sipërfaqe ndërtimi 57.0m² dhe sipërfaqe trualli 200 m² që ndodhet në ZK 8641, lagjja Nr. 2, Sarandë me nr. Pasurie 17/335 dhe kufizohet nga veriu me pallat, nga jugu me pasurinë 17/336, nga lindja me pasurinë 17/337 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 17/40.

4. Të miratojë Vendimin Nr. 1/1, datë 24.10.2017 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtëshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkesues *Dhurata Tushini, Tahir Sulejmani dhe Bardhyl Sulejmani* (subjekti *Dhurata Tushini, Tahir Sulejmani dhe Bardhyl Sulejmani bazuar në testamentet bashkëlidhur kësaj dosje me gjeneralitetet sipas çertifikatës me përbërje familjare të vitit 1974-1985*) për një objekt banimi (2 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 95.2 m² kati përdhe; 132 m² kati i pare dhe sipërfaqe trualli 200 m² që ndodhet në ZK 8641, lagjja Nr. 1, Sarandë me nr. Pasurie 11/365 dhe kufizohet nga veriu me pasurinë 11/5, nga jugu me pasurinë 11/369, nga lindja me pasurinë 11/24 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 11/363.

Sekretari i Këshillit të Qarkut
Vllasi Nasaj